

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË “AICA IMOBILIARE” SH.P.K.**

Sot më datë 22 Dhjetor 2021, **Z. Armand Hoxha**, i biri i Muharremit, i datëlindjes 24.03.1974, lindur në Radë, Durrës shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**AICA IMOBILIARE**” **sh.p.k.** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**AICA IMOBILIARE**” **sh.p.k.**, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm **Z. Armand Hoxha**.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**AICA IMOBILIARE**” **sh.p.k.** do të jetë:

Ndërtim, zhvillim, shfrytëzim hotelesh dhe zone turistike Çdo lloj veprimtarie të ligjshme që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.

4. Selia e shoqërisë

1. Selia e Shoqërisë “**AICA IMOBILIARE**” **sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Fshati Muçaj, ZK 2726, nr. pasurie 142/46, vol.9, fq.157, Vorë.
2. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**AICA IMOBILIARE**” **sh.p.k.** është 10 000 Euro.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë "**AICA IMOBILIARE**" sh.p.k. është **Z. Irfan Maskaj**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "**AICA IMOBILIARE**" sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.


Ngarkohet Administratori, Z. Irfan Maskaj të depozitojë dokumentacionin e themelimit të shoqërisë dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm

Armand Hoxha

Hoxha Armand


Irfan Maskaj
